



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE
Drejtoria e Administrimit te Prones Publike

URDHER
Nr. 137 Date 15/10.2002

PER ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE
SH.A. "UJESJELLES" DURRES

Drejtuar : Gjykates se Rrethit Tirane

Duke marre parasysh shkresen Nr. 7121, date 10.10.2002 te Ministrise se Rregullimit te Territorit dhe Turizmit "Dokumentacioni per zmadhimin e kapitalit te shoqerise", dhe raportin e Ekspertit Kontabel,

KONSTATOVA

Se ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996 dhe neni 171 i ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", me cilesine e aksionerit te vetem ,

URDHEROJ :

Ne aktet e themelimit te Sh.A "Ujesjelles" Dures te behen ndryshimet e meposhtme:

1. Kapitali Themeltar te zmadhohet per vleren 185,196,000 leke e barabarte me 185,196 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.
2. Kapitali Themeltar i Sh.A "Ujesjelles" Dures te behet nga 261,772,000 leke ne 446,968,000 leke e barabarte me 446,968 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.

Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.

3. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit te Prones Publike per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare".

Arben MAHAJ
MINISTER



RAPORT

I

EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR

Une I quajturi Sabri Zalla, me detyren e ekspertit kontabel te autorizuar, I ngarkuar nga Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit me Urdherin nr.556, date 16.10.2000, per vertetimin e bilancit te Ndermarrjes Kanalizimeve Durres, pasuria e se ciles I shtohet kapitalit themeltar te Ujesjellesit Sh.A.Durres, paraqes raportin tim si me poshte:

Nga muaji Janar deri ne Shtator te vitit 2002, kam ndjekur punen e komisionit te ndermarrjes se Kanalizimeve Durres dhe te eksperteve vleresues, lidhur me percaktimin e kapitalit themeltar, I cili do t'i shtohet kapitalit themeltar te Ujesjellesit Sh.A.Durres.

Nga verifikimet e kryera konstatoj se komisioni ka respektuar rregullat e parashikuara ne V.K.M. nr.194, date 20.03.1998 "Per kriteret e percaktimit te kapitalit themeltar te shoqerise shteterore", dhe te Udhezimit te perbashket te Ministrise Ekonomise Publike dhe Privatizimit e Agjensise Kombetare te Privatizimit nr.1, date 15.05.1998, per zbatimin e Vendimit te siperm.

Regjistrimet kontabile nga Ndermarrja e Kanalizimeve Durres, per veprimet lidhur me percaktimin e kapitalit themeltar jane kryer ne menyre te plote e te rregullt.

Bilanci I transformuar me 31.12.2001, I Ndermarrjes Kanalizimeve Durres, jep nje pamje te sinqerte e besnike te pasurise e te gjendjes financiare te ndermarrjes.

Kapitali I percaktuar prej leke 185.196.000 (njqindetetedhjetepesemiljonenjqindenentedhjetegjashtemije), I pergjigjet vleres se aktiviteti neto te ndermarrjes.

Durres, me 30.09.2002

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

(Sabri Zalla)

SABRI ZALLA
EKSPERT KONTABEL
I AUTORIZUAR

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 24509/4 Akt.

VENDIM
I
GJYQTARIT TE VETEM

Sot, me date 20.10.2002, une, gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane **Enkela Bajo**, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Zv.Ministri i Ekonomise per depozitim ne rregjistrin tregtar te urdherit nr.137, date 15.10.2002 dhe,

KONSTATOVA:

Se shoqeria "Ujesjelles" sh.a. Durres eshte rregjistruar si shoqeri anonime me vendimin nr.24509, date 11.10.2002 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.
Me urdherin nr.137, date 15.10.2002 te Ministrit te Ekonomise, me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise, eshte vendosur zmadhimi i kapitalit te shoqerise per vleren e sektorit te kanalizimeve prej 185.196.000 leke dhe kapitali themeltar behet nga 261.772.000 leke ne 446.968.000 leke, e barabarte me 446.968 aksuione me vlere nominale 1000 leke secili.
Nga shqyrtimi i akteve te paraqitura nga kerkuesi rezulton se ato jane te plota dhe kerkesa e bazuar ne ligj.

PER KETE ARSYE:

Ne baze te nenit 24 te ligjit nr.7667, date 28.01.1993

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses.
Depozitim e urdherit nr.137, date 15.10.2002 te Ministrit te Ekonomise per zmadhimin e kapitalit te shoqerise "Ujesjelles" sh.a. Durres, duke bere shenimin ne fleten e rregjistrimit ne kolonen 4 dhe 5 me nr. rendor 2.
Te ndahen rregjistrimet nga njeri-tjetri.
Te publikohet vendimi i mesiperm.

GJYQTAR

Enkela BAJO

